

Petro Çekrezi

vjersha

BIBLIOTEKA
SHTETIT



Dhjetë yje

814-1-93


543

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

PETRO ÇEKREZI

DHJETË VJE

Vjersha



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

RRUGËT EDHE SHITIGJET

Vrapojnë, vrapojnë
Udhët dhe shtigjet,
Në fusha tej
Pambuku rritet;
Vrapojnë lumenjtë
Nëpër turbina
Dhe bëhen forcë
Dhe lindin drita.

Vrapojnë, vrapojnë
Udhët dhe shtigjet
Udhë me hekur
Dhe me asfalt.
Ca në miniera
Dhe në uzina,
Të tjera ngjiten
Në male lart.

Ngjiten dhe zbresin
Rrugët dhe shtigjet
Lart në male,
Në kaltërsi.
Qielli ynë
Dhe det' i kaltër
Rrugë pa numër
Kanë tani.

Rrugë qytetesh,
Linja të gjata,
Drita dhe yje
Në hapësirë,
Damare të kaltra,
Duar me kallo,
Të gjitha rrugët
Tek ju kanë mbirë.

Dhe ne përherë
Atje do rendim
Ku udhët shtrin
Çdo pesvjeçar,
Metalurgjiku,
Ballsh dhe Fierzë,
Udhë të reja
Partia çan.

N Ë M A I.

Në malet bleroshe
Ku era shëtit,
Ku është një kasolle
Dhe një obelisk,

Atje në marshim
U ngjitëm një ditë;
Atje e kaluam
Një natë me barinjtë.

Ia thamë me fyell,
Kërcyem me gajde,
Andej ndaj të ngrýsur
E hapëm dhe radion.

Kur zjarri kërciste
Dhe ndizeshin yjtë,

Këmborët ia thoshin
Si kor brinjë më brinjë.

Kur ja, krejt papritur
Nga altoparlanti
Erdh zëri i Enverit,
Buçiti gjithë mali.

Erdh zëri i pastër,
Partia kish festë;
Gëzonte Atdheu
Dhe malet e rreptë.

Dhe grykat zërin
E çonin shumë larg;
Sikur ky zë
Të kish lindur në mal.

Sikur ky zë
të kish mbirë mbi shkëmbinjtë;
Ky zë që ka
binjakë lartësitë.

Dhe radioja heshti,
Po mali ushtonte;

Akoma me malet
Ky zë kuvendonte.

E mbajnë me vete
Këtë zë të dashur
Dhe njerëzit, dhe malet,
Fabrikat dhe arat.

Ai ish me ne
Një ditë te barinjtë,
Ku është një kasolle
Dhe një obelisk.

BATERIA VULLNETARE

Ne po kthehemi nga rrugt' e detit
Mbushur me stërkala dhe tallaz,
Bateria jonë e kreu detyrën,
Ndaj të lumtur kthehemi në bazë.

Ne këndojmë këngë marinarësh,
Dallgëzon flamuri mbi katart;
Pritna, pritna sot, qytet i dashur,
Ndrin flamuri ynë posi far.

Ndrin flamuri ynë e brigjet qeshin,
Ngjan qyteti tej si yll i madh;
Me «trofetë» që armikut ia rrëmbeu
Kthehet bateria vullnetare.

Shushuriti deti yn' i kaltër,
Deti hedh shkumë në liman,
Në shtigiet e detit vigjëlojmë,
Ku mbi dallgë rreh krahët pulëbardha.

KISHA NJË KALË

Një kalë të bardhë kisha unë,
Kuptonte si njeri;
E merrja netëve të verës
Dhe shkonim bashkë në brinjë.

E çoja netëve me hënë
Që të kulloste bar.
Kapistrën në një dorë e lidhja
Dhe i flija nën bark.

Ai kulloste qetë-qetë
Dhe mua s'më trazonte,
Po kur mbaronte bari pranë,
Posi njeri më zgjonte.

Dhe bashkë shkonim pak më tej,
Ku bari kish tërfil,

Dhe kur agimi fikte yjet,
Prapë ktheheshim të dy.

Por veç një natë kur hën'e re
Ish fshehur shpejt pas malit,
Një ulurimë erdh nga larg,
Ju ngritën jelet kalit.

Pastaj më zgjoi si gjithmonë,
Rrëmihu dhenë,
Dy sytë si hënëza shikonin,
Guxim për të më dhënë.

Jelet e bardha iu bënë shpatë
Patkonjtë i shkrepëtinin,
Po qentë e stanit kishin kohë
Që ujkun pas e ndiqnin.

Dhe fjeta prapë nën bark të tij,
I qetë, gjer n'agim.

.....
Kisha një kalë besnik e trim
Dikur në fëmini.